



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 104

Prishtinë, më 20.3.2014, në orën 9:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 1

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi, Behar Selimi, Ardian Gjini, Mufera Shinik, Albulena Haxhiu dhe Gëzim Kelmendi.

Munguan: Haki Demolli, Arsim Bajrami, Halit Krasniqi, Armend Zemaj dhe Sreten Ivanoviq.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Lumnije Murati – ZPRK, Sylë Ahmeti- Kosova Sot, Sanije Jusufi - Kosova Live, Norë Shabani - Koha Ditore, Fidan Rama - Tribuna, Dragana Dukiq – RTK 2, Driton Selmanaj - KDI, Qendresa Mrasori - KDI, Lejla Selimi - OSBE dhe Vlora Nushi UNMIK/OPA.

Nga stafi i Komisionit për Legjislacion: Fehmi Hyseni.

Mbledhjen e kryesoi, Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 14,18 dhe 19.2. 2014;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Arben Gashi, kryetar, para se ta hedh në votim rendin e ditës tha se tani më e keni mendimin e Qeverisë për Projektligjin. Siç e keni parë nuk ka ndonjë problem substancial që e pengon procedimin e Projektligjit për lexim të parë.

Albulena Haxhiu tha se ky Projektligj është paksa më i avancuar se ligji aktual edhe pse mbetet shumë që të ndryshohet. Ajo shprehu shqetësimin e saj lidhur me formulimin e nenit 108.2, pika b, duke shtuar se ky është një formulim të cilin nuk e ka votuar Komisioni. Formulimi i këtij neni në materialin e komisionit ad-hoc, për reformën zgjedhore ishte “ numri i përgjithshëm i votave të vlefshme, të fituara nga secili subjekt politik në zgjedhjet për Kuvend pjesëtohet me 1, 3, 5, 7, 9, 11, 13, 15, e kështu me radhë, derisa numri i pjesëtuesve të shfrytëzuar t’i përgjigjet numrit të plotë të vendeve” kurse në këtë Projektligj na është paraqitur diçka tjetër...

Kryetari Arben Gashi, ndërhyri në diskutimin e parafolësës dhe kërkoi që të deklarohen për rendin e ditës.

Deputetja Albulena Haxhiu, u largua nga mbledhja dhe Komisioni mbeti pa kuorum për të vazhduar mbledhjen, e cila u mbyll në mungesë të kuorumit.

Mbledhja përfundoi në orën 9:35

E përgatiti:
Stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetari i Komisionit
Arben Gashi